



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 330 Prot

Tiranë, më 18.02 2015

URDHËR

Nr. 87 datë 17.02.2015

PËR

KRITERET E VLERËSIMIT PËR PERSONELIN PROFESIONIST NË QENDRA
SHËNDETËSORE

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 4 e nenit 102 dhe neni 119, në zbatim të Vendimit nr. 737, datë 05.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor” dhe Statutit të Qendrave Shëndetësore;

URDHËROJ:

1. Njoftimi për vendet e lira të punës për personel profesionist në Qendrat Shëndetësore, bëhet me mjetet e informimit publik dhe duhet të përmbajë të dhëna mbi: pozicionin vakant, kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacionin që duhet paraqitur, kriteret e vlerësimit të kandidatëve, si dhe vendin dhe kohën e dorëzimit të dokumenteve.
2. Dokumenta të detyrueshme për të konkurruar për një vend të lirë pune janë: diploma universitare, certifikata e notave, licenca e urdhrit të profesionistit, dëshmia e penalitetit, dhe raporti mjekësor. Nëse pozicioni i lirë është për mjek specialist atëherë kërkohet edhe certifikata/diploma e specialitetit.
3. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Vlerësimi me pikë i kandidatëve bëhet sipas kriterëve të parashikuara në lidhjet nr.1 dhe nr.2 që i bashkëlidhen këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Lidhja Nr.1

Kriteret e vlerësimit për personelin profesionist: Mjekë dhe Mjekë Specialistë në Qendrat Shëndetësore

- I. Kandidati duhet të ketë mbaruar studimet e larta Universitare në Mjekësi të Përgjithshme me program të akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- II. Vlerësimi total për mjekët e përgjithshëm është 80 pikë, ndërsa për mjekët e specialiteteve është 100 pikë të klasifikuara si më poshtë:
 1. Nota mesatare - maksimumi 20 pikë:
 - a. Nota mesatare 9-10 vlerësohet me 20 pikë;
 - b. Nota mesatare 8-9 vlerësohet me 15 pikë;
 - c. Nota mesatare 7-8 vlerësohet me 10 pikë;
 - d. Nota mesatare 6-7 vlerësohet me 5 pikë;
 - e. Nota mesatare 5-6 vlerësohet me 3 pikë.
 - 1.1 Për mjekët e specialiteteve, vlerësimi i specializimit bëhet sipas kriterëve vijuese:
Nota mesatare - maksimumi 20 pikë:
 - f. Nota mesatare 9-10 vlerësohet me 20 pikë;
 - g. Nota mesatare 8-9 vlerësohet me 15 pikë;
 - h. Nota mesatare 7-8 vlerësohet me 10 pikë;
 - i. Nota mesatare 6-7 vlerësohet me 5 pikë;
 - j. Nota mesatare 5-6 nuk ka vlerësim.
 2. Njohja e gjuhëve të huaja - maksimumi 15 pikë:
 - a. Mbrojtja e një gjuhe të huaj (angleze, franceze, italiane ose gjermane) vlerësohet me 5 pikë;
 - b. Mbrojtja e një gjuhe tjetër të huaj vlerësohet me 3 pikë;
 - c. Per kandidatët që kanë studiuar jashtë Shqipërisë, mbrojtja e gjuhës së huaj nuk ka nevojë të provohet me dëshmi.
 3. Grada shkencore – maksimumi 15 pikë:
 - a. Studime Doktorature –10 pikë;
 - b. Kur doktoratura nuk lidhet me specializimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, vlerësohet maksimalisht me 8 pikë;
 - c. Studime Master - 5 pikë.
 - d. Kur studimet Master nuk lidhen me specializimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, vlerësohet maksimalisht me 3 pikë.
 4. Eksperienca në profesion - maksimumi 20 pikë:
 - a. 1-5 vjet eksperiencë – 5 pikë;
 - b. 5-10 vjet eksperiencë - 10 pikë;
 - c. 10-15 vjet eksperiencë – 15 pikë;
 - d. Mbi 15 vjet eksperiencë – 20 pikë.
 5. Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh profesionale me afat mbi 2 javë – maksimumi 10 pikë:
 - a. Të lidhura me pozicionin e punës për të cilin konkurrohet – 2 pikë secila;
 - b. Në fusha të tjera – 0.5 pikë secila;
 - c. Kualifikimet e kryera për një afat jo më pak se 8 javë kur lidhen me profesionin – 4 pikë.

Lidhja Nr.2

Kriteret e vlerësimit për personelin profesionist: Infermier në Qendra Shëndetësore

- I. Kandidati duhet të ketë mbaruar studimet e larta Universitare në Infermieri të Përgjithshme, me program të akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- II. Vlerësimi total është 70 pikë të klasifikuara si më poshtë:
 1. Nota mesatare - maksimumi 20 pikë:
 - a) *Nota mesatare 9-10 vlerësohet me 20 pikë;*
 - b) *Nota mesatare 8-9 vlerësohet me 15 pikë;*
 - c) *Nota mesatare 7-8 vlerësohet me 10 pikë;*
 - d) *Nota mesatare 6-7 vlerësohet me 5 pikë;*
 - e) *Nota mesatare 5-6 nuk ka vlerësim.*
 2. Njohja e gjuhëve të huaja - maksimumi 15 pikë:
 - a) *Mbrojtja e një gjuhe të huaj (angleze, franceze, italiane ose gjermane) vlerësohet me 5 pikë;*
 - b) *Mbrojtja e një gjuhe tjetër të huaj vlerësohet me 3 pikë;*
 - c) *Per kandidatët që kanë studiuar jashtë Shqipërisë, mbrojtja e gjuhës së huaj nuk ka nevojë të provohet me dëshmi.*
 3. Grada shkencore – maksimumi 15 pikë:
 - a) *Studime Doktorature –15 pikë;*
 - b) *Kur doktoratura nuk lidhet me specializimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, vlerësohet maksimalisht me 10 pikë;*
 - c) *Studime Master - 10 pikë;*
 - d) *Kur studimet Master nuk lidhen me specializimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, vlerësohet maksimalisht me 5 pikë.*
 4. Eksperiencia në profesion - maksimumi 10 pikë:
 - a) *1-5 vjet eksperiencë – 2 pikë;*
 - b) *5-10 vjet eksperiencë - 4 pikë;*
 - c) *10-15 vjet eksperiencë – 8 pikë;*
 - d) *Mbi 15 vjet eksperiencë – 10 pikë.*
 5. Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh profesionale me afat jo më pak se 2 (dy) javë – maksimumi 10 pikë:
 - a) *Të lidhura me pozicionin e punës për të cilin konkurrohet – 2 pikë secila;*
 - b) *Në fusha të tjera – 0.5 pikë secila;*
 - c) *Kualifikimet e kryera për një afat jo më pak se 8 javë kur lidhen me profesionin – 4 pikë.*